



REPUBLIKE KOSOVES / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDËR KORRUPTIONIT / AGENCJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPC
Dep.	
Dep.	
Nr. urac.	02
Blok Stranica	
Nr. pages	
Nr. Prot. 03-02/3292/17	
Blok Prot. 03-02/3292/17	
Date:	16.10.2017
Datum:	
Date:	
DOKUMENT	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPTIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
 ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 16.10.2017, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbylllet rasti me nr. AKK-03-02-2537/17, për zyrtarin e lartë z.Gent Begolli, Drejtor në Drejtorin e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit në Komunën e Prishtinës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik .**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2537/17,që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z.Gent Begolli, Drejtor në Drejtorin e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit në Komunën e Prishtinës.**

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z.Gent Begolli, Drejtor në Drejtorin e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit në Komunën e Prishtinës figuron si pronar dhe person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korruptionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z.Gent Begolli ka ardhur dhe është takuar me zyrtarët e AKK-së, ne ket takim zyrtaret e AKK-së, e kanë njoftuar zyrtarin e lartë me faktet qe posedon Agjencia lidhur me



rastin e iniciuar, z.Begolli, është pajtuar me faktet e prezantuara, por është arsyetur se nuk ka pasur njohuri qe emri tij figuron ne ketë biznes pasi qe nuk ka qen i angazhuar as njëherë ne ketë biznese, por është zotuar se brenda afatit ligjor do ti ndërmerr te gjitha veprimet për ti ber ndryshimet dhe do te veproj sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Pas këtij takimi jemi njoftuar nga z.Begolli se ka qen ne Administratën Tatimore të Kosovës dhe është njoftuar se ky biznes nuk ka zhvilluar aktivitet po ashtu ka kontaktuar me bashkëpronarin e tij nga i cili është njoftuar nga aji e ka regjistruar ketë biznes mirë po nuk ka zhvilluar aktivitet.

Pas këtyre veprimeve të ndërmarra nga z.Gent Begolli, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se Gent Begolli, nuk figuron me si person i autorizuar në biznesin privat me emër D.P.H“Piccuku” .

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra, nga zyrtari i lartë z.Gent Begolli, Drejtor në Drejtorin e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit në Komunën e Prishtinës, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si person i autorizuar ne biznesin privat janë krijuar rrëthana të reja dhe ështëshmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z.Gent Begolli, Drejtor në Drejtorin e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit në Komunën e Prishtinës, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

